

PROCESVERBAL

**nga seanca e 20-të e Këshillit të Agjencisë për
Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 20.5.2022**

Anëtarë të pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë:
Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës i kryetarit të Këshillit të ASHMA-së, mr.Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski, dr.Metodija Jançeski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional: mr.Dragica Ljubevska, Goran Radunoviq, mr.Emilija Petreska Kamenjarova, Maja Damevska, dr.Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë:/

Z. Petrushevski e hapi seancën e 20-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:05 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri mirato si në vijim:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbali nga seanca e 19-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, e mbajtur më 17.5.2022.
2. Propozim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për marrje të lejes për transmetim në radio ndaj SHTR RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup me nr.08-78, datë 5.1.2015.
3. Propozim për (inici) ngritjen e procedurës për kundërvajtje ndaj SHTR TV SITEL SHPKNJP Shkup për shkelje të nenit 53 paragrafi (2) të LSHMAAV.
4. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj SHTR televizionit IRIS SHPK Shtip për shkelje të nenit 15 paragrafi (5) të Ligjit për media.
5. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi miratoi njëzëri Procesverbalin nga seanca e 19-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive e më mbajtur 17.5 2022 me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Trajçeovski arsyetoi Propozimin për ndërprerjen e procedurës së inicuar për marrje të lejes për transmetim në radio ndaj SHTR RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup nr. 08-78 të datës 5.1.2015. Ai ka sqaruar se në seancën e 18-të të mbajtur më 16.5.2022, Këshilli ka iniciuar procedurë për marrje të lejes për radio transmetim për arsye se transmetuesi nuk e ka paguar tarifën vjetore në afatin e caktuar. Por dy ditë më parë RA HIT i ka paguar fondet, për këtë arsye propozohet ndërprerja e procedurës së nisur.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për marrje të lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup, nr. 08-78, datë 5.1.2015.

Me datën 17.5.2022, transmetuesi në fjalë ka kryer pagesën në shumë prej 97.049,00 (nëntëdhjetë e shtatë mijë e dyzet e nëntë) denarë, me të cilat e ka paguar në tërësi tarifën vjetore për lejen e transmetimit në radio.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli duhet të publikojë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 3

Ndihmës udhëheqësja e Sektorit për Çështje Programore mr. Emilija Petreska Kamenjarova ka arsyetuar Propozimin për iniciimin e procedurës kundërvajtëse ndaj SHTR TV SITEL SHPKNJP Shkup për shkelje të nenit 53 paragrafi (2) të LSHMAAV. Sqaroi se bëhet fjalë për Raport nga mbikëqyrja e kontrollit të kryer. Konkretisht, para disa seancave Këshilli i ka lëshuar vërejtje publike TV Sitel për komunikime të fshehta komerciale audiovizuale duke i udhëzuar që të veprojnë menjëherë pas marrjes së raportit. Nga mbikëqyrja e kontrollit u rezultua se TV Sitel nuk ka vepruar sipas Vendimit për shqiptim të masës. U konstatua se kësaj here nuk kishte komunikime të fshehta komerciale audiovizive për produktet në fjalë por kishte lloje të tjera produktesh të pashënuara si paraqitje komerciale të paraqitura si bisedë në kuadër të programit të mëngjesit. Për shkak se transmetuesi nuk e respektoi Ligjin propozimi në Këshill është që të inicohet procedurë kundërvajtëse.

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të kontrollit programor nr. 10-1987/1 të datës 13.5.2022 ndaj SHTR TV SITEL SHPKNJP Shkup konstatoi shkelje të nenit 53 paragrafit (2) të LSHMAAV.

Këshilli njëzëri konkludoi se ndaj SHTR TV SITEL SHPKNJP Shkup që të inicojë procedurë kundërvajtëse pranë gjykatës kompetente sepse mbikëqyrja ka konstatuar se transmetuesi i përmendur më 26.4.2022, në emisionin informativë-argëtues "Ja sakam Makedonija", ka transmetuar komunikim të fshehtë komercial audioviziv të enëve për gatim që shiten nga "Komodita xoym", gjë që është në kundërshtim me nenin 53 paragrafi (2) të LSHMAAV.

Spektori për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik duhet të përgatisë Kërkesën për fillimin e procedurës për kundërvajtje pranë gjykatës kompetente për transmetuesin në fjalë.

Pika 4

Ndihmës udhëheqësja e Sektorit për Çështje Programore mr. Emilija Petreska Kamenjarova ka shpjeguar Propozimin për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj Televizionit

SHTR IRIS SHPK Shtip për shkelje të nenit 15 paragrafi (5) të Ligjit për media. Shpjegoi se raporti është nga mbikëqyrja e rregullt administrative. Të gjithë transmetuesit kanë obligim ligjor jo më vonë se data 31 mars të vitit aktual ndër raportet e tjera që paraqesin për llogaridhënie duhet të paraqesin edhe raportin për përmbushjen e konceptin programor në formular të veçantë të përgatitur nga ASHMA-ja. Mirëpo, TV Iris nuk e ka dorëzuar raportin as brenda afatit ligjor dhe as pas afatit dhe për këtë arsye i propozohet Këshillit që të shqiptojë masë vërejtje publike.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e rregullt administrative, nr.10-1825/1 datë 29.4.2022 dhe njëzëri konkludoi që t'i shqiptohet masë vërejtje publike Televizionit SHTR IRIS SHPK Shtip sepse në afatin e paraparë me ligj (31.3.2022).) nuk i ka paraqitur Agjencisë raportin me shkrim për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në lejen për transmetim televiziv, veçanërisht për zbatimin e konceptit programor, as informacion për mjetet teknike me të cilat transmetohet ose ritransmetohet shërbimi programor në vend apo jashtë tij, me ç'rast nuk i përmbush obligimet nga neni 15 paragrafi (5) i Ligjit për media.

Në pajtueshmëri me pikën 7 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për të vepruar sipas vendimeve të Agjencisë për marrjen e masave (tekst i zbardhur) nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, është urdhëruar brenda 45 ditëve nga dita e pranimit. të vendimit për harmonizim të veprimtarisë së tij me dispozitat e Ligjit për Media.

Spektori për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik duhet të përgatisë vendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Pas skadimit të afatit të përcaktuar në Vendimin për vërejtje publike, Spektori për Çështje Programore kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli duhet të publikojë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 5

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

Nr.02-2038/5

27.05.2022

Shkup

Agjencia për Shërbime Mediatike

Audio dhe Audiovizuale

Kryetari i Këshillit

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v